

E DREJTA E GJYKIMIT BRENDA AFATIT TË ARSYESHËM

Emine ZENDELI*

Abstrakt: *E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është një ndër parimet më të rëndësishme të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ). Në nenin 6 alinea 1. të saj, çështja e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore është shqyrtuar në lidhje me mbrojtjen kundër kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më datë 10.04.1997 ka ratifikuar këtë Konventë dhe si rezultat, ndër të tjera, ka marrë edhe obligimin nga neni 6 alinea 1.e kësaj Konvente, që të garantojë të drejtën e realizimit të drejtave dhe obligimeve të qytetarit në “afate të arsyeshme”. Me ratifikimin e Konventës janë krijuar kushtet që edhe qytetarët e RM-së, të mund të iniciojnë padi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sa herë që konsiderojnë se me zgjatjen deri në pafundësi të procedurave gjyqësore u është shkelur e drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Me qëllim të mbrojtjes efikase të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe me qëllim të evitimit të pasojave negative që mund t’i shkaktohen shtetit, nëse qytetarët në masë të madhe i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (RM-së në vitin 2007 u detyrua të paguante kompensim prej 90.000,00 €, për shkeljen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm), RM-së duhet të ndër marrë masat përkatëse me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të punës së gjykatave.*

Fjalët çelës: *Gjykimi në një afat të arsyeshëm, Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Gjykata Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.*

1. Hyrje

Në kuadër të aktivitetit të mekanizmave të posaçëm lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në organizatën e Këshillit Evropian¹ dhe harmonizimit përkatës të legjislacionit të shteteve anëtare me standardet e vendosura bashkërisht, janë diferencuar disa parime të reja që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore. Ndër parimet më të rëndësishme padyshim është edhe parimi i gjykimit brenda afatit të

* Mr.sc. Emine Zendeli, asistente dhe ligjëruese e lëndëve civile në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë.

¹ Këshilli i Evropës është organizatë ndërkombëtare rajonale e formuar me 5 maj 1949 nga Traktati i Londrës, nënshkruar nga dhjetë shtete, përkatësisht: Belgjika, Franca, Danimarka, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar. Ajo është organizata e parë politike e formuar në Evropë me idenë për bashkimin e Evropës, realizimin e demokracisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Dy organet kryesore të krijuar në kuadrin e Këshillit të Evropës në lidhje me të drejtat e njeriut janë Komisioni (i cili është abroguar tashmë) dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

arsyeshëm. E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është e drejtë themelore procedurale e njeriut e garantuar me Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (KEDNj).² Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ka ratifikuar këtë Konventë, dhe si rezultat RM-së ka marrë edhe obligimin nga (neni 6 alinea 1.) e kësaj Konvente, që të garantojë të drejtën e realizimit të drejtave dhe obligimeve civile të qytetarit në “afate të arsyeshme”.³ Në nenin (6. alinea 1.), sipas të cilit “çdokush ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm, para gjykatave të pavarura dhe të paanshme të krijuara në bazë të ligjit”, çështja e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore është shqyrtuar në lidhje me mbrojtjen kundër kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut të paraparë në (nenin 5) të Konventës.⁴ Sipas qëndrimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut,⁵ shtetet nënshkruese të Konventës janë të obliguara që të organizojnë sistem juridik efikas, ku gjykatat do të jenë në gjendje që qytetarëve t’u garantojnë të drejtën e sjelljes së vendimit meritore në kontestet nga lëmia e të drejtës civile brenda afatit të arsyeshëm. Me ratifikimin e Konventës janë krijuar kushtet që edhe qytetarët e RM-së, të cilët konsiderojnë se u është shkelur e drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, të mund të parashirojnë padi në Gjykatën evropiane për të drejtat e njeriut.

E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është përmbajtur edhe në Ligjin mbi gjykatat të Republikës së Maqedonisë, („Gazeta zyrtare e RM-së „ nr. 58/2006 dhe 35/2008), në (nenin 6, alinea 2.) të të cilit thuhet se: “gjatë vendosjes për të drejtat dhe obligimet civile, si dhe gjatë vendosjes për përgjegjësi penale, secili ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm, para gjykatës së pavarur dhe të paanshme, të themeluar në bazë të ligjit”. Po t’i referohemi dispozitës së lartpërmendur do të mund të konstatojmë se e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm mbron në mënyrë të njëjtë të drejtat në procedurë civile dhe të drejtat në procedurë penale. Por, kësaj radhe fusha e interesit na lidh me të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm të të drejtave civile.

Parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është rregulluar edhe me (nenin 10 alinea 1) të Ligjit mbi procedurën kontestimore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 79/2005), sipas të cilit “gjykata duhet të insistojë që procedura të zhvillohet pa zvarritje, brenda

² Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1950, ndërkohë që Konventa dhe protokollat e saj 1,4,6, dhe 7 janë ratifikuar nga Kuvendi i RM-së më 10.04.1997. Në vazhdim do t’i referohemi vetëm si: Konventë

³ Termi “të drejtat dhe obligimet civile” sipas Konventës ka kuptim autonom dhe ka të bëjë me të drejtat civile lidhur me të cilat vendoset në procedurë kontestimore dhe administrative. Periudha e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm tek këto çështje mund të fillojë të rrjedhë edhe para inicimit të procedurës, (atëherë kur shteti është fajtor për pengimin e fillimit të procedurës, ose kur nuk ofron me kohë ndihmë juridike), dhe të përfundojë me përmbartimin e vendimit. Përgjegjësia e shtetit vazhdon derisa pala të ketë realizuar të drejtën e fituar në procedurë.

⁴ Neni 5. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

⁵ Është organ gjyqësor i instaluar nga Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të Këshillit evropian më 1950. Ajo kontrollon zbatimin e Konventës, është e autorizuar të veprojë sipas ankesave dhe parashitësive të individëve nga vendet nënshkruese të Konventës, atëherë kur ata konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me Konventë, ndërkohë që kanë harxhuar të gjitha mjetet juridike në kuadër të sistemit juridik të vendit që padisin.

afatit të arsyeshëm, me sa më pak shpenzime, si dhe të pamundësojë çdo keqpërdorim të të drejtave që u takojnë palëve në procedurë”. Në pajtim me (nenin 297 alinea 2) të Ligjit mbi procedurën kontestimore, është obligim i kryetarit të trupit gjykues, respektivisht gjyqtarit individual, të kujdeset që objekti i kontestit të shqyrtohet nga të gjitha aspektet, por, megjithatë procedura të mos zvarritet, ashtu që shqyrtimi sipas mundësisë të përfundojë në një seancë. Mirëpo, kjo rregull shumë rrallë zbatohet në praktikë.

Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm është edhe pjesë e planit strategjik të Ministrisë së drejtësisë së RM-së, për periudhën 2008-2010, i cili ka për qëllim plotësimin e kushteve të cilat duhet të përmbushen në rrugën e RM-së drejt familjes evropiane, respektivisht, realizimin e prioriteteve që lidhen me krijimin e një sistemi efikas, të pavarur dhe profesional gjyqësor, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, rritjen e efikasitetit të punës së gjykatës etj.⁶

2. Kuptimi i kërkesës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm

Tradicionalisht e drejta për gjykim brenda “afatit të arsyeshëm” ose e drejta në “gjykim të shpejtë”, siç quhet akoma, shihet si garanci për mbrojtjen e palëve nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave. Kërkesa për gjykim brenda afatit të arsyeshëm garanton se brenda një afati të arsyeshëm me anë të vendimit gjyqësor do të përfundojë pasiguria në aspekt të pozitës civilo-juridike të subjekteve të së drejtës. Kjo kërkesë shtrohet në interes të dyfishtë, të personave me të cilët ka të bëjë drejtpërdrejtë, si dhe në interes të sigurisë së përgjithshme juridike.⁷ Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm nuk është kategori fikse e përcaktuar në mënyrë strikte, por, është fjala për një standard të cilin gjykata e vlerëson në mënyrë të veçantë për çdo rast konkret.⁸ Nëse një afat është i arsyeshëm, ose jo, vlerësohet nga rasti në rast. Koha e cila llogaritet si afat i arsyeshëm fillon të rrjedhë nga momenti i inicimit të procedurës përkatëse, e deri në momentin e përfundimit të saj në instancën më të lartë të mundshme. Sipas praktikës së Gjykatës evropiane edhe procesi i përmbarimit të vendimeve gjyqësore paraqet pjesë integrale të të drejtave themelore të njeriut, që do të thotë se parimi i „gjykimin në afat të arsyeshëm” nuk përfshin vetëm periudhën e sjelljes së vendimeve gjyqësore, me të cilat vetëm konstatohen të drejtat e qytetarëve në procedurë kontestimore, por, edhe procedurën e përmbarimit (ekzekutimin e dhunshëm). Pra, edhe sfera e përmbarimit të vendimeve gjyqësore është e mbrojtur nga Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

⁶ Strateshki plan na ministerstvoto za pravda 2008-2010, januari, 2008, (përkthim- Plani strategjik i ministrisë së drejtësisë 2008-2009, janar, 2008.

⁷ Milutinović Ljubica, Suđenje u okviru Razumnog Vremenskog roka, pravni Informator, br.11/2004, Beograd.

⁸ Elijash Marko, Pravo na suđenje u razumnom roku, Zagreb, 2006.

Gjykimi në afat të arsyeshëm nuk përfshin kohën e përfshirë në afate ligjore dhe ato gjyqësore, por, megjithatë prof. Stefan Georgievski mendon se “në organizimin normativ të procedurës ka hapësirë për një shkurtim të saj, edhe atë qoftë sa i përket instancave dhe mjeteve juridike, ashtu edhe sa i përket fazave në procedurë të shkallës së parë”.⁹ Gjatë vlerësimit të kërkesës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, ka parasysh rrethanat konkrete të rastit edhe atë:

- 1) kompleksitetin e çështjes;
- 2) qëndrimin e parashtruesit të kërkesës;
- 3) qëndrimin e pushtetit
- 4) llojin e kontestit.

Kompleksiteti i çështjes vlerësohet duke pasur parasysh të gjitha aspektet e çështjes, të cilat mund t’i referohen, si gjendjes faktike, ashtu edhe asaj juridike. Kompleksiteti i çështjes në disa raste arsyeton zvarritjen e procedurës.¹⁰

Parashtruesi i kërkesës i cili ka shkaktuar shtyrjen e procedurës, nuk ka të drejtë të thirret në shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Megjithatë, kjo nuk mund të shfrytëzohet kundër tij, respektivisht, nuk mund të ndikojë në dëmtimin e pozitës së tij si palsi palë në procedurë.

Për të gjitha shtyrjet e procedurës që i ka shkaktuar pushteti gjyqësor, ose administrativ është përgjegjës shteti. Gjatë zgjidhjes së këtyre rasteve që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurës Gjykata evropiane niset nga parimi i zbatimit gjegjës të të drejtës. Nëse zvarritja e procedurës në gjykatë është vetëm çështje e përkohshme, dhe paraqet përjashtim, ndërkohë që shteti shpejtë ka ndërmarrë masat e domosdoshme për pengimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata evropiane nuk do të konstatojë shkeljen e kësaj të drejte të garantuar. Mosndërmarrja e masave përkatëse mund të çojë në përgjegjësinë e shtetit. Megjithatë, në të gjitha rastet Gjykata evropiane merr parasysh situatën politike dhe shoqërore në shtetin për të cilin bëhet fjalë.

Kur bëhet fjalë për llojin e kontestit, nga gjykata kërkohet që të jetë efikase kur është në pyetje procedura që ka rëndësi të veçantë për parashtruesin e parashtrësës, ka specifika të veçanta, ose karakter të humbjes së përhershme të së drejtës. Kjo më së shpeshti ka të bëjë me rastet kur vendoset lidhur me pozitën e fëmijëve, personave të moshuar ose të paafte, lidhur me kompensimin e dëmit për dëmtimet e rënda trupore, rastet nga marrëdhëniet e punës si dhe rastet e tjera që kanë të bëjnë me ekzistencën e njeriut.¹¹ Sipas (nenit 405) të Ligjit mbi procedurën kontestimore, në procedurën lidhur me kontestet nga marrëdhëniet e punës, veçanërisht gjatë përcaktimit të afateve, gjykata

⁹ Georgievski Stefan, Nova naçela građanskog pravosuđenja, Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol.56 No.2-3.2006.

¹⁰ Milutinoviç Ljubica, Sudeње u okviru Razumnog Vremenskog roka, pravni Informator, br.11/2004, Beograd.

¹¹ Milutinoviç Ljubica, Sudeње u okviru Razumnog Vremenskog roka, Pravni Informator, br.11/2004, Beograd.

mban llogari për nevojën e zgjidhjes urgjente të kontesteve nga këto marrëdhënie. Në procedurën lidhur me kontestet nga marrëdhëniet e punës, afati për përgjigje në padi është tetë ditë. Kur bëhet fjalë për konteste nga marrëdhëniet e punës që kanë të bëjnë me pushimin e marrëdhënies së punës, seanca për shqyrtim kryesor duhet të mbahet në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të përgjigjes në padi. Lidhur me kontestet nga marrëdhëniet e punës, procedura në gjykatën e shkallës së parë duhet të përfundojë në afat prej 6 muajsh nga dita e parashtrimit të padisë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë është e obliguar që vendimin lidhur me ankesën kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ta sjell në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës, respektivisht në afat prej 2 muajsh, nëse në gjykatën e shkallës së dytë mbahet shqyrtim.

Pushteti gjyqësor mban përgjegjësinë më të madhe për sigurimin e përfundimit të shpejtë të procedurës, edhe atëherë kur palët shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike procedurale që i kanë në disponim sipas të drejtës vendore. Megjithatë, edhe pse potencohet përgjegjësia e gjykatës, shteti është ai që përgjigjet për të gjitha organet e veta, e jo vetëm për gjykatat. Gjykata në Strasburg nuk është e obliguar të vërtetojë se cili organ shtetëror është përgjegjës për mospërmbushjen e obligimeve ndërkombëtare.

3. Qëllimi i parimit të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm

Me anë të rregullave që kanë të bëjnë me të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm nga gjyqtari kërkohet drejtësi ligjore dhe efikase. Drejtësia ligjore ka kuptimin e verifikimit të fakteve relevante dhe zbatimit të drejtë të normave procedurale dhe materiale,¹² ndërkohë që drejtësia efikase synon që këto qëllime të ligjshmërisë të arrihen në afat sa më të shkurtër, në mënyrë që subjekti që kërkon të drejtën dhe mbrojtjen juridike, ta fitojë atë sa më parë.

Shumë shpesh në praktikë ligjshmëria dhe efikasiteti nuk shkojnë së bashku. Megjithatë, nuk duhet harruar se instituti i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm paraqet një të arritur të kulturës juridike të botës së civilizuar e cila i përgjigjet sigurisë juridike të çdo qytetari.¹³ Në raste të shpeshta së bashku me shprehjen gjykim në afat të arsyeshëm shkojnë edhe shprehjet “e drejta në gjyqësi”, “e drejta në qasje gjykatave”, “e drejta në gjykim të pavarur dhe të drejtë”, “e drejta në gjykim të drejtë”. E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, sipas kësaj është e drejtë në drejtësi të shpejtë (efikase), por, njëkohësisht edhe drejtësi të drejtë. Përndryshe, nëse këto qëllime nuk do të harmonizoheshin e drejta në gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk do të kishte kuptim.¹⁴ Qëllimi i punimit është gjykimi brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të ngushtë, edhe

¹² Radoloviç Aldo, Zashitja prava na suđenje u razumnom roku, Zbornik pravnog fakulteta Sveučilište u Rijeci, br.1 (2008), fq.6.

¹³ Radoloviç Aldo, Zashitja prava na suđenje u razumnom roku, Zbornik pravnog fakulteta Sveučilište u Rijeci, br.1 (2008), fq.6.

¹⁴ Po aty, fq.6

pse është e qartë se gjykimi brenda afatit të arsyeshëm duhet të kënaqë edhe të gjitha atributet e theksuara më parë.

Shtrohet pyetja nëse dëshirojmë drejtësi efikase apo të ligjshme? Në fakt, ekzistojnë pikëtakime ku takohen drejtësia efikase dhe ajo ligjore, respektivisht gjykimi brenda afatit të arsyeshëm është parakusht për një gjykim të drejtë.¹⁵ Dilemë juridike paraqet çështja nëse kohëzgjatja e procedurës gjyqësore (procesi i realizimit të së drejtës) duhet të përcaktohet saktësisht në kohë, ose mjafton vetëm standardi juridik „gjykimi brenda afatit të arsyeshëm“. Në favor të përcaktimit të saktë të afatit flet fakti se mungesa e afatit paraqet rrezik real të anashkalimit të qëllimit të këtij instituti.¹⁶

E drejta gjermane praktikon përcaktimin e saktë të afateve. Kështu, me urdhër të Ministrisë gjermane të drejtësisë të datës 26.08.2005, është përcaktuar kohëzgjatja prej 4, 4 muaj për gjykim në shkallë të parë dhe 7.1. muaj për gjykim në shkallë të dytë. Ekzistojnë mendime se gjykimi brenda afatit të arsyeshëm, respektivisht përcaktimi i afateve strikte mund të ndikojë negativisht në pavarësinë e gjyqtarit i cili planifikon kohën e gjykimit. Megjithatë, duket më i pranueshëm mendimi, sipas të cilit gjyqtari vazhdon të jetë krejtësisht i pavarur në sjelljen e vendimit, edhe pse atë duhet ta sjell brenda një afati të caktuar saktë.

Në RM-së, ligjdhënësi deri më tani nuk ka praktikuar përcaktimin e saktë të kohës së gjykimit (edhe pse për disa procedura thuhet se janë urgjente, p.sh. procedurat nga marrëdhëniet e punës). Megjithatë, mendoj se në sistemin tonë gjyqësor, ashtu sikurse, edhe në sistemet gjyqësore të botës së civilizuar, duhet respektohet standardi juridik “gjykim brenda afatit të arsyeshëm”, por, përmasat e këtij standardi duhet të përcaktohen duke pasur parasysh situatën konkrete në gjyqësinë tonë:

- kemi një numër të madh të lëndëve të pazgjidhura, edhe pse kemi numër të mjaftueshëm gjyqtarësh,
- kemi pengesa strukturale në shoqëri dhe aparat gjyqësor, të cilat gjenerojnë paraqitjen e një numri të madh të lëndëve të mbetura, të cilat pengojnë punën në lëndët e tjera,
- gjyqtarët tanë nuk kanë kushte të volitshme për punë,
- mungon niveli i kulturës juridike të pjesëmarrësve të tjerë në gjykim,
- shteti harxhon shuma të mëdha të hollave në emër të kompensimit për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Nëse këto mjete do t'i harxhonte për avancimin e kuadrove, rinovimin e objekteve gjyqësore, rregullimin e hapësirave nëpër gjykata, kompjuterizimin e tyre etj. nuk do të kishim këtë situatë që e kemi .

¹⁵ Tanasković Zoran, Ljudska prava i osnovne slobode koje shtiti Evropska Konvencija, Pravni informator, br 1/ 2004.

¹⁶ Radolović Aldo, Zashitita prava na suđenje u razumnom roku, Zbornik pravnog fakulteta Sveučiliste u Rijeci, br.1 (2008), fq. 7.

Duke pasur parasysh situatën aktuale që ekziston në RM-së, duhet të përcaktojmë afate më të gjata, të cilat do të mund t'i respektonim, edhe atë sipas formulës:

- një vit për procedurën në shkallë të parë,
- tetë muaj për procedurën në shkallë të dytë (në të drejtën gjermane ky afat ishte më i gjatë se ai i shkallë së parë)
- gjashtë muaj për revizion
- tre muaj për përmbarim (edhe pse përmbarimi në legjislacionin e RM-së, më nuk është procedurë gjyqësore, duhet të përfshihet brenda afatit të arsyeshëm, sepse ajo, megjithatë, është fazë e realizimit të së drejtës, ashtu sikundër janë edhe të tjerat).

4. Rregullimi normativo-juridik i mbrojtjes së të drejtës në gjykim brenda afatit të arsyeshëm

Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore është një nga problemet më të vështira të gjyqësisë në RM-së, prandaj edhe mbrojtja e të drejtës në gjykim brenda afatit të arsyeshëm, për momentin, është një nga çështjet më të rëndësishme juridike dhe politike. Kjo, mbase për faktin se ky është një institut i importuar nga jashtë, që rregullohet me standarde ndërkombëtare, respektivisht, (neni 6. alinea 1.) i Konventës, kërkon që gjykimi i çështjeve civile në procedurë gjyqësore civile të bëhet në afat të arsyeshëm, dhe për këtë arsye shtron parimet më të rëndësishme për administrimin e shpejtë të drejtësisë. Instituti i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm aktualisht është i rregulluar me dispozitat (nenet 6, 35, 36) të Ligjit mbi gjykatat. Por, le të ndjekim retrospektivën e zhvillimit të tij në kornizën normative të RM-së, pa të cilën nuk mund të gjykojmë për rregullimin aktual të tij.

4.1 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm

E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk është mbrojtur në mënyrë eksplicite me Kushtetutë¹⁷. Megjithatë, ky parim obligon drejtpërdrejt Republikën e Maqedonisë, sepse sipas nenit 118. alinea 1. të Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar në bazë të Kushtetutës është pjesë e rendit të brendshëm juridik, dhe sipas fuqisë juridike qëndron mbi ligjin.¹⁸ Parimi themelor sipas të cilit të drejtat dhe liritë e njeriut nuk duhet të konsiderohen vetëm si çështje të brendshme të shtetit, por, si vlera universale të cilat garantohen, edhe me aktet e të drejtës ndërkombëtare, determinon nevojën që këto të drejta dhe liri të njeriut të mbrohen me Kushtetutë, si akt më i lartë juridik brenda shtetit. Ky parim nuk ka gjetur zbatim në të

¹⁸ Neni 118, alinea 1, Kushtetuta e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare nr. 52/91, amendamentet e publikuara në Gazetën Zyrtare nr. 1/92, 31/98, 91/01, 84/03 dhe 107/05.

drejtën tonë. Në nenin 50. alinea 1. të Kushtetutës së RM-së, është përcaktuar e drejta e qytetarëve që mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre ta realizojnë para gjykatave të rregullta, ndërsa para Gjykatës Kushtetuese ata mund të realizojnë vetëm ato të drejta që në mënyrë të shprehur janë të theksuara në nenin (110 alinea 3),¹⁹ ku gjithsesi nuk është përfshirë e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Nga sa u tha, mund të konstatohet se Gjykata Kushtetuese e RM-së ka “kompetencë restriktive” për sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore, madje ajo mbron vetëm ato të drejta që janë të theksuara shprehimisht në këtë dispozitë, e jo edhe të gjitha liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë.²⁰

Për “Kompetencën restriktive” të Gjykatës Kushtetuese flet edhe Ligji mbi gjykatat, në nenin (6. alinea 1.) të të cilit thuhet se: gjykatat ofrojnë mbrojtje gjyqësore të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, si dhe subjekteve të tjerë juridik, përpos atyre që janë në kompetencë ekskluzive të Gjykatës kushtetuese.²¹ Me këtë dispozitë kushtetuese u janë cënuar të drejtat e qytetarëve. Ata janë privuar nga e drejta e parashtrimit të padisë kushtetuese²² për mbrojtjen e të drejtës së gjyimit brenda afatit të arsyeshëm. Po të kishin të drejtë të iniciojnë padi kushtetuese para Gjykatës Kushtetuese, kjo do të ishte vetëm një mjet juridik më tepër për hulumtimin e shkeljeve të të drejtave të tyre (dhe të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm), dhe padyshim do të ndikonte në reduktimin e numrit të ankesave para Gjykatës evropiane.²³

E drejta e parashtrimit të padisë kushtetuese duhet të parashihet në mënyrë eksplicite në rendin juridik nacional, konkretisht në Kushtetutën e RM-së, më saktë, në pjesën ku bëhet fjalë për kompetencën e Gjykatës kushtetuese, dhe të sqarohet në mënyrë më të detajuar me Ligj të veçantë kushtetues. Sjellja e një Ligji kushtetues të Gjykatës Kushtetuese, do të ngrinte kualitetin e përpunimit të çështjeve lidhur me kompetencën,

¹⁹ Liria e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, e bashkimit dhe veprimit politik dhe ndalimit të diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, besimit fetar, përkatësisë nacionale, sociale dhe politike.

²⁰ Kushtetuta nuk duhet të ketë qasje selektive, sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive nga ana e Gjykatës kushtetuese, përkatësisht nuk duhet të mbrojë vetëm të drejta dhe liri të caktuara, por, duhet të ofrojë mbrojtje juridike për të gjitha të drejtat dhe liritë, qoftë nëpërmjet Gjykatës kushtetuese, ashtu edhe nëpërmjet Gjykatave themelore.

²¹ Gjykatat e rregullta nuk i mbrojnë liritë dhe të drejtat si kompetencë të posaçme, por, përmes zgjidhjes së kontesteve në lëmi të ndryshme të së drejtës.

²² Padia kushtetuese është instrument për mbrojtjen e të drejtave individuale të qytetarëve, të cilën mund ta iniciojë secili qytetar i cili konsideron se me një vendim të sjellë nga pushteti gjyqësor, administrativ, ose nga organe të tjera të cilat ushtrojnë autorizime publike i është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

²³ Duke pasur parasysh përvojat pozitive të vendeve të cilat në sistemin juridik të tyre kanë instaluar padinë kushtetuese si instrument individual procedural për mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut, si dhe nevoja e sigurimit të një shkalle më të lartë të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave, është koha që Gjykata kushtetuese e RM-së, të fillojë të mendojë për zgjerim të kompetencave në sferën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, pasi është më se evidente tendenca bashkëkohore sipas të cilës sistemet juridike nuk mjaftohen vetëm me një mjet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve, por përcaktojnë më tepër mjete procedurale.

organizimin e brendshëm, aktivitetet e Gjykatës dhe çështje të tjera që aktualisht rregullohen me akt nënligjor.

Në shumicën e demokracive perëndimore evropiane, ku parimi i vendim-marrjes së shpejtë është pothuaj universal, mosrespektimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm shumë shpesh paraqitet si shkak për iniciimin e padisë kushtetuese.²⁴ Kështu, në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar se gjykata e rregullt nuk do të respektojë parimin e gjyimit brenda afatit të arsyeshëm, dhe me këtë do të çënojë të drejtat kushtetuese të qytetarit, në disponim të qytetarit është padia kushtetuese.²⁵ Nëse Gjykata Kushtetuese duke vepruar sipas padisë kushtetuese konstaton se bëhet fjalë për shkelje të parimit për gjykim në afat të arsyeshëm, ka mundësi që me anë të vendimit, të caktojë një afat të caktuar për zgjedhjen meritorë të çështjes nga ana e gjykatës së rregullt. Ky afat do të fillojë të rrjedhë nga dita e shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Shembull të mundësisë për parashtrim të padisë, ose në origjinal (ankesë-Verfassungsbeschwerde) me anë të së cilës pala kërkon mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kemi në Kushtetutën gjermane, ku në (nenin 20 alinea 4, dhe nenet 33, 38, 101,103 dhe 104), thuhet se: „çdo qytetar i cili pretendon se me akt të ndonjë organi shtetëror, qoftë federal ose krahinor (ligjdhënës, ekzekutiv ose gjyqësor) i është shkelur ndonjë nga të drejtat e tij themelore të garantuara me Kushtetutën Federale, ka të drejtë të parashtrijë padi drejtuar Gjykatës federale“.²⁶ Përndryshe, Gjermania nuk ka ligj të veçantë për rregullimin e të drejtës së gjyimit brenda afatit të kuptueshëm, por, instituti i gjyimit brenda afatit të arsyeshëm (angemessene Verfahrensdauer) nxirret nga (art. 4. neni 19) i Kushtetutës.²⁷ Edhe në Kushtetutën kroate (neni 128.alinea 3.) thuhet se “qytetarët kanë të drejtë të parashtrijë padi kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me kushtetutë”. Kjo dispozitë kushtetuese, ashtu si edhe në Kushtetutat e tjera evropiane, aludon në të gjitha të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë, dhe nuk specifikon liri dhe të drejta të caktuara, ashtu siç bën Kushtetuta e RM-së.²⁸ Çështja e gjyimit brenda afatit të arsyeshëm është rregulluar konkretisht me (nenin 29) të Kushtetutës, ku thuhet se “çdokush ka të drejtë që gjykata e pavarur dhe e paanshme, në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm të vendosë për të drejtat dhe obligimet,

²⁴ Mark W. Janis- Richard S. Kay-Anthony W. Bradley, E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Prishtinë 2002, fq. 522.

²⁵Karakamisheva Tanja, “Analiza za potrebatna na voveduvanje ustavna zhalba (tuzhba) vo Republika Makedonija”, Praven Resursen Centar, Skopje, 2007, fq. 7.

²⁶Neni 93, alinea 4a, Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland vom 23. Mai 1949 (BGBl. S. 1), zuletzt geändert durch Artikel 1 des Gesetzes vom 19. März 2009 (BGBl. I S. 606) Sipas Kushtetutës gjermane (GG ose GrundG) e cila hyri në fuqi në vitin 23.05.1949, padia kushtetuese para Gjykatës Kushtetuese, mund të parashtrijet vetëm ndaj vendimeve të formës së prerë dhe atëherë kur janë konsumuar të gjitha mjetet e tjera juridike të parapara në sistemin juridik nacional, pra ajo ka karakter ndihmës. Hans D. Jarass-Bodo Pieroth: *Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland. Kommentar*. Beck. 10. Auflage 2009.

²⁷ Përkundraz, e drejta italiane çështjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm e rregullon me ligj të veçantë, Legge Pinto, nr .89/2001

²⁸ E drejta në padi kushtetuese është e rregulluar me Ligjin kushtetues të Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë (nenin 28, Ustaven zakon na Usta ven sud na Republika Hrvatska (Narodne novine br.31/91; br.49/02).

ose për përgjegjësinë penale të tij”. E drejta e parashtrimit të padisë kushtetuese parashihet edhe në Kushtetutën sllovene (160. pika. 6)²⁹ dhe në Kushtetutën e Shqipërisë.³⁰

4.2 Rregullimi ligjor i mbrojtjes së të drejtës në gjykim brenda afatit të arsyeshëm

Instituti i gjyimit brenda afatit të arsyeshëm është rregulluar me dispozitat e Ligjit mbi gjykatat (2006),³¹ respektivisht, në mënyrë më detale me dispozitat e Ligjit mbi ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi gjykatat (2008).³²

Në (nenin 35, alinea 1. pika 6.) të Ligjit mbi gjykatat (2006), çështja e mbrojtjes së të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm numërohet si një nga kompetencat e gjykatës supreme, ndërkohë që (neni 36), shqyrton të drejtën e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, edhe atë: “pala e cila konsideron se gjykata kompetente ka shkelur parimin e gjyimit brenda afatit të arsyeshëm, ka të drejtë të parashtrorë kërkesë për mbrojtjen e kësaj të drejte, drejtuar gjykatës më të lartë, e cila është e obliguar që brenda afatit prej gjashtë muajsh nga parashtrimi i kërkesës, të vendosë nëse gjykata më e ulët ka shkelur të drejtën në fjalë. Nëse vërteton shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm me vendim përkatës do të caktojë kompensim (i cili bie mbi buxhetin e gjykatës) për palën që ka parashtruar kërkesën”. Ligji mbi gjykatat (2006) nuk definojnë të drejtën e gjyimit brenda afatit të arsyeshëm, por, sidoqoftë, edhe ashtu siç është e rregulluar me ligjin në fjalë dhe me Konventë, ka kuptimin e standardit juridik përmbajtjen kazuistike të të cilit në esencë e determinon Gjykata evropiane³³.

Në kontekst të asaj që theksuam më sipër, mjeti juridik procedural, i përcaktuar me (nenin 35, alinea 1. pika 6.) të Ligjit mbi gjykatat (2006), fatkeqësisht, mbeti në kornizat e një përpjekjeje jofunksionale për rregullimin e këtij instituti. Kjo ishte e pajustifikueshme, aq më tepër kur çështja e gjyimit brenda afatit të arsyeshëm nuk ishte krejtësisht e panjohur, pasi që në mënyrë episodike ishte përmendur edhe në Ligjin mbi

²⁹ Për më tepër shih.: Karakamisheva Tanja „Analiza za potrebat na voveduvanje ustavna zhalba (tuzhba) vo Republika Makedonija“ Praven Resursen Centar, Skopje, 2007, fq. 7.

³⁰ E drejta në padi kushtetuese është paraparë edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, date 21.10.1998 dhe e azhurnuar me: 9675/07 dhe 9904/08 (neni 131. pika f.), sipas të cilës Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

³¹ Neni 35, alinea 6, dhe neni 36, alinea 1,2,3,4, Ligji mbi gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.58/2006;

³² Neni 3, 4 dhe 5, Ligji mbi ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.35/2008.

³³ Triva Sinisha- Dika Mihailo, Gradansko parnično procesno pravo, Zagreb, 2009, fq. 207.

gjkatat (1995),³⁴ dhe tanimë kishte 9 vite që Republika e Maqedonisë kishte ratifikuar Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (nga 10.04.1997)³⁵. Vullneti i ligjvënësist, por, padyshim edhe presioni politik dhe diplomatik evropian, veçanërisht i Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut ndikoi në sjelljen e Ligjit mbi ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi gjkatat (2008). Ky ligj krijoi një model më të operacionalizuar të mjetit juridik procedural për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Sipas dispozitave të këtij ligji, (nenit 35 alinea 1 pika 6), shprehjes „të vendosë lidhur me kërkesat e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në procedurë të caktuar me ligj para gjkattave në RM-së, i’u shtuan fjalët: “në përputhje me rregullat dhe principet e përcaktuara nga Konventa evropiane, dhe duke u nisur nga përvoja e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut”.³⁶

Në nenin (36, alinea 1), fjalët: “gjkata drejtpërdrejt më e lartë” u zëvendësuan me fjalët “Gjkata supreme e RM-së”, që do të thotë se për të vendosur lidhur me të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është caktuar ekskluziviteti i Gjykatës supreme. Pas alinesë (1), shtohen edhe dy aline të tjera (2) dhe (3). Sipas alinesë (2 të nenit 36): “kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm mund të parashtrohet gjatë kohës së procedimit para gjkattave të vendit, dhe më së voni gjashtë muaj nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit”. Në vijim, në alinenë (3 të nenit 36) është përcaktuar përmbajtja e kërkesës për mbrojtje të të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm: “kërkesa duhet të përmbajë: 1/ të dhëna për parashtruesin e kërkesës dhe përfaqësuesin juridik të tij; 2/ të dhëna për objektin e gjykimit dhe procedurën gjatë të cilës, pala konsideron, se është bërë shkelja e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm; 3/ arsyetim për shkaqet për të cilat është bërë shkelja e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm; 4/ deklaratë për kërkesë të kompensimit në të holla; 5/ nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës”.

Alinea (4 e nenit 36) e cila zëvendëson alinenë (2) të Ligjit mbi gjkattat (2006), përcakton se: “Gjkata supreme e RM-së do të veprojë sipas kërkesës e cila përmban elementet e theksuara më sipër, në afat prej gjashtë muajsh nga parashtrimi i saj, dhe do të vendosë nëse gjkata më e ulët ka shkelur të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat dhe parimet e Konventës Evropiane dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës evropiane”. Gjatë procesit të vendosjes për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, gjkata merr parasysh:

³⁴ Neni 7, Ligji mbi gjkattat, Gazeta Zyrtare e RM-së Nr. 36/1995; “çdokush ka të drejtë në qasje të barabartë para gjkattave për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të bazuara në ligj. Çdokush ka të drejtë në gjykim ligjor, të paanshëm, të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm”.

³⁵ Një rregullim i tillë sipërfaqësor mund të arsyetohet me faktin se teoria dhe praktika juridike në vendin tonë në aspektin filozofik e as në atë sociologjik nuk ishte përgatitur për një institut të tillë siç ishte gjykimi brenda afatit të arsyeshëm, i cili u importua, huazua, thujse u imponua nga Evropa. Ligjvënësist i mungonin njohuritë teorike dhe praktike mbi këtë institut. Gjyqtarët në RM-së deri më tani nuk ishin të edukuar për „gjykim brenda afatit të arsyeshëm”.

³⁶ Neni 3, Ligji mbi ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi gjkattat, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.35/2008.

- kompleksitetin e çështjes,
- sjelljen e palëve në procedurë, dhe
- sjelljen e gjykatës që ka proceduar çështjen,

Në alinenë (5 të nenit 36), e cila zëvendëson alinenë (3) të Ligjit mbi gjykatat (2006), thuhet se: “nëse Gjykata supreme vërteton se është bërë shkelje e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, me anë të vendimit do të caktojë një afat brenda të cilit gjykata para të cilës është duke u proceduar çështja, duhet të vendosë për të drejtën obligimin, ose përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm”. Alinea (6 e nenit 36), e cila zëvendëson alinenë (4), precizon se kompensimi në të holla i cili duhet t’i jepet parashtruesit të kërkesës tangon buxhetin e gjykatës, dhe duhet të paguhet në afat prej tre muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit të Gjykatës supreme.³⁷

Në nenin e ri, 36a, Ligji mbi ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi gjykatat, rregullon procedurën para gjykatës supreme. Në alinenë (1) thotë se: “pas pranimit të kërkesës Gjykata supreme, menjëherë, ose më së voni në afat prej 15 ditësh do të kërkojë nga gjykata e shkallës së parë që të ofrojë përshkrim të akteve nga dosja e lëndës, dhe sipas nevojës, edhe deklaratë nga gjykata e lartë për kohëzgjatjen e procedurës para saj”. Në (alinenë 2 të nenit 36a), thuhet se: “lidhur me kërkesën për mbrojtje të të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata supreme vendos në trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh në seancë të mbyllur, përjashtimisht gjykata mund të dëgjojë parashtruesin e kërkesës dhe përfaqësuesin e gjykatës procedura e të cilës është objekt i kërkesës së parashtruar”. Dhe në fund (alinea 3 e nenit 36a), përcakton të drejtën e ankesës: “kundër vendimit të Gjykatës supreme, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej tetë ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të vendimit. Lidhur me ankesën do të vendosë Gjykata supreme, si gjykatë kompetente për të vendosur në shkallë të dytë kundër vendimeve të trupave të vet gjykues, kur kjo është paraparë me ligj” (neni 35. alinea 1. pika 1).³⁸

Ligji mbi gjykatat ka lënë të hapur çështjen e natyrës juridike të procedurës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Shtrohet pyetja, nëse bëhet fjalë për procedurë kontestimore ose jokontestimore? Sipas (nenit 1) të Ligjit mbi procedurën kontestimore, gjykatat veprojnë sipas rregullave të procedurës kontestimore në rastet kur shqyrtojnë dhe vendosin lidhur me kontestet që dalin nga të drejtat dhe obligimet themelore të njeriut dhe qytetarit, marrëdhëniet personale dhe familjare, të punës, tregtare, pasurore dhe konteste të tjera civilo-juridike, nëse për disa prej tyre me ligj nuk është përcaktuar se gjykata do t’i zgjidh sipas rregullave të ndonjë procedure tjetër. Sipas kësaj, procedura për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm do të duhej të udhëhiqet sipas rregullave të procedurës kontestimore. Mirëpo, kjo do të çonte në procedimin e kontestit në kontest. Prandaj, e vetmja zgjidhje logjike,

³⁷ Neni 4, Ligji mbi ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.35/2008.

³⁸ Neni 5, Ligji mbi ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.35/2008.

do të ishte që kjo procedurë adezive të udhëhiqet sipas rregullave të procedurës jokontestimore.

4.3 Ratifikimi i Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe gjykimi brenda afatit të arsyeshëm

Republika e Maqedonisë ka ratifikuar Konventën evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut më 10 prill 1997. Rëndësia e Konventës është përcaktuar me (nenin 118. alinea 1.) të Kushtetutës, e cila marrëveshjeve ndërkombëtare u jep statusin e burimit për të drejtën vendase, dhe obligon gjykatat vendase të respektojnë standardet të cilat ajo përcakton. Njëri nga këto standarde është edhe “gjkimi brenda afatit të arsyeshëm” (neni 6. alinea 1.) që obligon shtetin tonë, si nënshkrues të Konventës, t’ua garantojë këtë të drejtë qytetarëve të saj. Ky parim obligon gjykatat vendase të procedojnë procedurat brenda afatit të arsyeshëm, në të kundërtën, çdo zvarritje e paarsyeshme e procedurës do të konsiderohet shkelje e (nenit 6. alinea 1.) të Konventës, dhe do të rezultojë me të drejtën e palës që t’i drejtohet Gjykatës evropiane me kërkesë për mbrojtje të të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

Në (nenin 35. alinea 1.) të Konventës është përcaktuar se, qytetarët e pakënaqur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore para gjykatave të shteteve nënshkruese, mund të parashtrajnë kërkesë për mbrojtjen e kësaj të drejte para Gjykatës evropiane, vetëm pasi të kenë konsumuar mjetet juridike mbrojtëse brenda sistemit juridik vendas, në të kundërtën kërkesa do të hidhet poshtë si e palejueshme.

Në aspekt të kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore para gjykatave të RM-së, duhet dalluar tri situata të mundshme. Situata e parë ka të bëjë me grupin e procedurave të filluara dhe të përfunduara para ratifikimit të Konventës. Lidhur me këtë grup, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut nuk mund të veprojë, sepse bëhet fjalë për procedura që kanë zgjatur para ratifikimit të Konventës. Situata e dytë ka të bëjë me procedurat e filluara pas ratifikimit të Konventës. Ky është grup i rëndësishëm i procedurave, të cilave duhet kushtuar kujdes i veçantë, në mënyrë që vendi ynë mos të sanksionohet nga ana e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut për shkelje të obligimeve të mara me Konventë. Situata e tretë është më komplekse sepse ka të bëjë me procedurat shumëvjeçare të filluara para ratifikimit të Konventës, të cilat zgjasin edhe pas ratifikimit të saj, të ashtuquajturat “lëndë të tranzicionit”. Lidhur me këto lëndë ekziston përgjegjësia e shtetit për kohëzgjatjen e procedurës pas ratifikimit të Konventës.³⁹ Në këtë kontekst, shteti duhet të marrë të gjitha masat që këto procedura të përfundojnë me vendim meritor. Në procesin e vlerësimit të kohëzgjatjes së një procedure gjyqësore, nëse ajo ka përfunduar brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut merr parasysh edhe gjatësinë dhe natyrën e kohëzgjatjes para ratifikimit të Konventës.

³⁹ Milutinoviç Ljubica, Sudeñje u okviru Razumnog Vremenskog roka, pravni Informator, br.11/2004, Beograd.

Mungesa e kornizës normative adekuate (mjetit juridik procedural efikas) për mbrojtje të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, brenda sistemit juridik të RM-së, ka rezultuar me një ekspansion të ankesave kundër RM-së para Gjykatës evropiane nga ana e qytetarëve të saj. Gjykata Evropiane qartë na ka bërë me dije për mungesën e mjetit juridik efikas, ndër të tjera edhe në vendimin mbi rastin *Atanaseviq dhe të tjerët kundër RM-së*.⁴⁰ Në rastin *Atanaseviq dhe të tjerët kundër RM-së*, parashtuesi i ankesës i referohet (nenit 6. alinea 1.) të Konventës, duke aluduar në zvarritjen e pa arsyeshme të procedurës gjyqësore civile (padia është ngritur në vitin 1989) dhe (nenit 13) të Konventës, me të cilën përcaktohet mjeti juridik efikas për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë rast, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, gjatë vendosjes lidhur me shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, për herë të parë me aktgjykim konstaton se është shkelur (neni 13) i Konventës i cili parasheh se: „çdo individ të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e garantuara me Konventë duhet të ketë mjet juridik efikas për mbrojtjen e tyre para organeve nacionale, pa marrë parasysh, se shkelja është bërë nga personat gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”. Mjeti juridik do të jetë efikas në kuptim të (nenit 13.) të Konventës, nëse arrin të evitojë shkeljen e të drejtave dhe lirive (të ndikojë në sjelljen më të shpejtë të vendimit nga ana e organit që vepron lidhur me lëndën), ose të sigurojë kompensim përkatës nëse ato veç janë shkelur. Në sistemin juridik të RM-së nuk ekziston një mjet juridik efikas lidhur me ankesat ndaj shkeljes së të drejtës së gjyimit brenda afatit të arsyeshëm, kjo është edhe arsyeja kryesore që ndikon në numrin e madh të ankesave të qytetarëve të saj para Gjykatës evropiane.

Të dhënat statistikore të Gjykatës evropiane tregojnë se (5) ankesat e para kundër RM-së nga ana e qytetarëve të saj u paraqitën menjëherë në vitin 1998, dhe vazhduan me një tendencë rritjeje marramendëse. Kështu, në vitin 1999 u paraqitën (31) ankesa, në vitin 2000 (41), në vitin 2001 (59), në vitin 2002 (95), në vitin 2003 (148), në vitin 2004 (148), në vitin 2005 (234), në vitin 2006 (343), në vitin 2007 (454) dhe në vitin 2008 (395)⁴¹. Numri i përgjithshëm i ankesave ndaj Republikës së Maqedonisë nga viti 1998 deri më 31.12.2008 është 1745 ankesa⁴². Nga numri i përgjithshëm i ankesave kundër Republikës së Maqedonisë, 90% janë nga lëmia e procedurës gjyqësore civile, prej tyre 76% janë në procedurë kontestimore e veçanërisht nga sfera e të drejtës së punës. Edhe më tej lëndët e vjetra përmbarese të mbetura me decenie nëpër gjykata kontribuojnë në akumulimin e vazhdueshëm të lëndëve përmbarese, të cilat po të shikohen në kontekst të procedurës kontestimore shumëvjeçare në çështjet nga marrëdhëniet e punës, paraqesin

⁴⁰*Atanaseviq dhe të tjerët kundër Republikës së Maqedonisë*, Nr. 13886/02, 22.12.2005 (të dhëna nga interneti <http://www.pravda.gov.mk>).

⁴¹Godishen izveshtaj za sostojbata na predmeti protiv Republika Makedonija pred Evropskiot sud za çovekovi prava za 2008 godina, Skopje, aprill 2009 (Përkthim: Raport vjetor për gjendjen e lëndëve kundër Republikës së Maqedonisë për vitin 2008, Shkup, prill 2009).

⁴²Është me rëndësi të theksohet se ankesat lidhur me shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk janë karakteristike vetëm për Republikën e Maqedonisë. Përkundrazi, ankesat sipas kësaj baze paraqesin afër 50% të të gjitha ankesave drejtuar Gjykatës Evropiane.

problemin më kompleks të gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë. Nga numri i përgjithshëm i ankesave 95% prej tyre i drejtohen Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

Risi në praktikën e gjykatës evropiane sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve është pajtimi, ose të ashtuquajturat (marrëveshje miqësore), dhe deklaratat e njëanshme (neni 38. alinea 1). Për lëndët e parashtruara nga viti 2007, gjykata që në fillim të procedurës palëve u jep mundësi për pajtim, me nënshkrimin e deklaratës, sipas të cilës palët marrin obligime përkatëse, p.sh. Qeveria e RM-së, se do të paguaj shumën e caktuar të të hollave ankuesit, ndërsa ankuesi se do të heqë dorë nga çfarëdo lloj kërkesë ndaj RM-së, dhe të pranojë se pajtimi paraqet zgjidhjen meritore të çështjes. Rast i tillë është rasti *Janeva kundër Republikës së Maqedonisë*,⁴³ që u iniciua me qëllim të mbrojtjes së të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm (neni 6. alinea1). Lidhur me këtë rast gjykimi para Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut përfundoi me marrëveshje miqësore. RM-së, nëpërmjet agentit të Qeverisë morri obligimin që në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të aktgjykimit, të paguajë një shumë prej 77,000-€, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, si edhe të shpenzimeve të procedurës para gjykatave vendase. Ankuesi pranoi propozimin, hoqi dorë nga çfarëdo kërkesë plotësuese ndaj RM-së, dhe deklaroi se kjo paraqet zgjidhje meritore të çështjes.

Është me rëndësi të theksohet se të gjitha lëndët që gjatë vitit 2008 mbaruan me pajtim (marrëveshje miqësore) kishin të bënin me shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, si arsye më e shpeshtë për të cilën individët i drejtohen Gjykatës evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

5. Situata aktuale dhe masat që duhet të ndërmerren me qëllim të rritjes së efikasitetit në procedurë

Në vitet e fundit gjykatat në RM-së kanë fituar në efikasitet, ky fakt rezulton nga të dhënat e ofruara nga ministria e drejtësisë. Në Gjykatat e RM-së gjatë vitit 2008 janë pranuar gjithsej 546.254 lëndë të reja, pra 212.000 mijë lëndë, ose 22 % më pak se vitin e kaluar, ndërkohë që janë zgjidhur 8010 lëndë më tepër se vitin 2007. Në të gjitha gjykatat numri i lëndëve të pazgjidhura është zvogëluar për 239.000 lëndë, respektivisht për 26 % në krahasim me vitin 2007, dhe 257.603 lëndë, ose 28 % në krahasim me vitin 2006. Kjo flet për efikasitetin e punës së gjykatave, përderisa shtatëmbëdhjetë vite me radhë ka pasur rritje galopante të numrit të lëndëve të pazgjidhura.⁴⁴

Në këtë kuadër duhet përfshirë edhe numrin e lëndëve të papërfunduara (jo të gjitha lëndët përfundohen). Kështu, në vitin 1997 nga numri i përgjithshëm i lëndëve që duhej të përmbroheshin, prej gjithsej 263.070 u përmburuan vetëm 163.124, ndërsa të pa

⁴³ *Janeva kundër Republikës së Maqedonisë*, Nr. 58185/00, 03.10.2002. (të dhëna nga interneti <http://www.pravda.gov.mk>).

⁴⁴ 212,000 mijë lëndë gjyqësore më pak se vitin e kaluar, "Fakti", 29.12.2008, fq. 4.

përmbaruara mbetën 99.946 lëndë nga sfera e përgjithshme. Tendenca ishte në rritje, kështu, në vitin 2000 numri i lëndëve të pa përmbaruara arriti në 201.421, në vitin 2003 në 210.588 lëndë, në vitin 2004 numri i lëndëve të pa përmbaruara arriti në 299.944, ndërsa në 2005 në 429.192 lëndë të pa përmbaruara.

Tanimë është konsumuar e drejta që si arsytim për mosëfikasitetin e punës së gjykatave të theksohet: organizimi joefikas i sistemit gjyqësor vendas, numri i gjyqtarëve nëpër gjykata, zgjidhjet joadekuate dhe të vjetruara, mungesa e mjeteve materiale, etj. Në këtë drejtim, nga viti 2005 e këndej janë marrë masa me qëllim të ndryshimit të kornizës ligjore procedurale, si, të Ligjit mbi procedurën kontestimore, Ligjit mbi procedurën jokontestimore, Ligjit mbi përmbarrimin dhe Ligjit mbi gjykatat.

Ligji mbi gjykatat ka sjellë një organizim të ri në sistemin gjyqësor të RM-së. Sipas dispozitave të këtij ligji,⁴⁵ gjykatat themelore vendosin vetëm në shkallë të parë lidhur me padinë. Ato mund të veprojnë si gjykata me kompetenca themelore, dhe si gjykata me kompetenca të zgjeruara, ndërkohë që gjykatat e apelit tanimë nuk veprojnë në shkallë të parë lidhur me padinë, por, vetëm si gjykata të shkallës së dytë, sipas ankesave. Numri gjyqtarëve nëpër gjykata është zvogëluar. Kështu, nga gjithsej 530 gjyqtarë të gjykatave themelore, numri i tyre është zvogëluar në 466 gjyqtarë, nga 83 gjyqtarë të gjykatave të apelit, numri i tyre është zvogëluar në 77 gjyqtarë, kemi 21 gjyqtarë të gjykatës administrative, (krijimi i gjykatave administrative, si risi u përcaktua me Ligjin mbi gjykatat 2006), dhe numri i gjyqtarëve të gjykatës supreme u zvogëlua nga 24 në 20 gjyqtarë.⁴⁶ Zvogëlimi i numrit të gjyqtarëve, në asnjë rast, nuk shkon në dëm të efikasitetit të procedurave gjyqësore (Austria me 10000000 milion banorë ka 1700 gjyqtarë dhe një gjyqësi shumë efikase), por, është vetëm një hap drejt harmonizimit të sistemit gjyqësor vendas me sistemet gjyqësore evropiane.

Me qëllim të mbrojtjes efikase të drejtave themelore të njeriut dhe me qëllim të evitimit të pasojave negative që mund t'i shkaktohen shtetit nëse qytetarët në masë të madhe i drejtohen Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut, RM- së duhet të ndërmerr masa gjegjëse me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të punës së gjykatave. Në këtë drejtim priten efektet pozitive të ndryshimit të kornizës ligjore procedurale, si të Ligjit mbi procedurën kontestimore, Ligjit mbi procedurën jokontestimore, dhe Ligjit mbi përmbarrimin, me anë të këtij të fundit u vendos sistemi i ri përmbarrues (si masë sistemore reformuese të cilën shteti e ndërmorri me qëllim preventiv ndaj zvarritjes së procedurave).

Masat që mund të ndërmerren me qëllim të shkurtimit të procedurave gjyqësore civile konsistojnë në:

⁴⁵Ligji mbi gjykatat, („Gazeta zyrtare e RM „, nr. 58/2006 dhe 35/2008).

⁴⁶ Krahassimi është bërë me të dhënat nga -ABA/CEELI (American Bar Association/Central and Eastern European Law Initiative - raport për pjesëmarrjen e pakicave në profesionin juridik në Maqedoni, Shkup, shtator , 2004).

- në procedurën e shkallës së parë zvarritja e procedurës do të mund të evitohet, po qe se do t'i jepej prioritet parimit me shkrim, në mënyrë që parashtrirat të mos mund të parashtrihen gojarisht në procesverbal para gjykatave;

- mos të kufizohet hapësira e veprimtimit të gjyqtarit individual. Ai të veprojë në të gjitha rastet, ndërsa trupi gjykues vetëm në rastet e caktuara me ligj. Në këtë kontekst do të mund të shmangej edhe seanca përgatitore;

- Aplikimi i mediacionit si mënyrë alternative e zgjidhjes së konflikteve, do të çonte deri te shkarkimi i gjykatave nga numri i madh i lëndëve;

- Zbatimi konsekuent i Ligjit mbi taksat gjyqësore do të ndikonte në krijimin e mjeteve të cilat së bashku me mjetet e rregullta buxhetore do t'i ndihmonin shtetit që të mbulojë shpenzimet materiale të gjykatave;

- Kompjuterizimi i gjykatave dhe trajnimi i gjyqtarëve për përdorimin e kompjuterëve.

- Duke pasur parasysh përvojat pozitive të vendeve të cilat në sistemin juridik të tyre kanë instaluar padinë kushtetuese, si instrument procedural për mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut, si dhe nevojën e sigurimit të një shkalle më të lartë të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave, është koha që Gjykata kushtetuese e RM-së, të fillojë të mendojë për zgjerim të kompetencave në sferën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, pasi është më se e evidente tendenca bashkëkohore, sipas të cilës sistemet juridike nuk mjaftohen vetëm me një mjet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve, por përcaktojnë më tepër mjete procedurale. Vendosja e padisë kushtetuese si mjet juridik plotësues për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, do të krijonte më tepër mundësi për qytetarët, të cilët pretendojnë se u është shkelur kjo e drejtë.

- të depolitizohet përfundimisht pushteti gjyqësor, dhe të sigurohet pavarësia e tij nga ndikimet politike të pushteteve të tjera.

6. Përfundim

Gjykata evropiane ka konstatuar se gjykimi brenda afatit të arsyeshëm edhe më tej mbetet baza më e shpeshtë për shkeljen e të cilës qytetarët e RM-së ankohen para Gjykatës evropiane. Në lidhje me këtë janë evidentuar disa hapa në drejtim të përmirësimit të situatës. Ligji mbi ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi gjykatat, i cili më për së afërmi iu referua procedurës para Gjykatës supreme, (për dallim nga paraardhësi i vet i cili u vlerësua si jofunksional) arriti të operacionalizojë mjetin juridik me të cilin palët mund të kërkojnë mbrojtje juridike të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm drejtëpërdrejtë para gjykatave të vendit. Gjithnjë në mbështetje të ligjit në fjalë, rregullave dhe parimeve të Konventës Evropiane si dhe praktikës së Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut, Gjykata supreme filloi të procedojë kërkesat e palëve të

cilat kërkonin mbrojtje të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm⁴⁷. Në fillim të vitit 2009 Gjykata supreme solli vendime meritorë, me të cilat vlerësoi zvarritjen e procedurave gjyqësore, dhe për palët e prekura përcaktoi kompensime në të holla, të cilat përputhen me ato që caktohen nga Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut.

Sipas të dhënave, Gjykata supreme e RM-së ka pranuar 190 kërkesa për vërtetim të shkeljes së të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata ka vendosur për 80 prej tyre. Prej tyre, 8 janë sjellë si vendime meritorë, 24 janë refuzuar si të pabaza, dhe 43 janë hedhur poshtë. Një parashikim optimist do na jepte të drejtën të supozojmë, se nëse gjatë vitit 2009 mjeti i ri juridik për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, i instaluar me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi gjykatat (2008), pranohet dhe vlerësohet si efikas nga ana e Gjykatës evropiane do të rezultonte në uljen graduale të numrit të ankesave të qytetarëve të RM-së para Gjykatës evropiane. Derisa mos të ndodhë kjo qytetarët e RM-së, do të vazhdojnë të drejtohen para Gjykatës në Strasburg me ankesa për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, pa qenë të obliguar nga neni 35, alinea 1 e Konventës (i cili autorizon qytetarët që t'i drejtohen gjykatës evropiane vetëm pasi të kenë konsumuar mjetet juridike nacionale).

E gjithë ajo që theksuam, udhëzon në konstatimin se në RM-së po merren masa të përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave të përcaktuara me Konventë, veçanërisht të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, për të cilën sipas përvojës së deritanishme kanë arritur numër më i madh i ankesave para Gjykatës evropiane nga ana e qytetarëve të RM-së. Së pari duhet të priten rezultatet e zbatimit të ligjeve nga gjykatat të cilët janë në disponim të palëve, pasi një zbatim efikas i tyre në praktikë mund të ndikojë në zvogëlimin sistematik të problemit të gjyimit brenda afatit të arsyeshëm. Gjithsesi, ky problem nuk duhet të shihet si i ndarë por gjithnjë në kontekst të reformimit të përgjithshëm të sistemit gjyqësor në RM-së.

⁴⁷ Mbështetja e Gjykatës supreme të RM-së në rregullat dhe parimet e Konventës evropiane dhe praktikën e Gjykatës evropiane është një indikator i fuqishëm në zhvillimin e praktikës gjyqësore në gjyqësinë e RM-së, dhe në krijimin e opinionit pozitiv tek Gjykata evropiane, për sa i përket zbatimit të rregullave dhe parimeve të Konventës Evropiane dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane nga Gjykata më e lartë në RM-së (vendimet e Gjykatës evropiane të drejtësisë paraqesin burim të së drejtës në rendin juridik të Unionit Evropian dhe si të tilla janë të obligueshme). Kjo mund të ndikojë për të dëshmuar edhe efikasitetin e mjetit juridik të brendshëm, për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Përderisa mjeti juridik nuk vlerësohet si efikas nga Gjykata evropiane palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës evropiane dhe ajo është e obliguar të veprojë sipas ankesave të tyre, pa pasur të drejtë që sipas nenit 35 alinea1. të Konventës t'i hedh poshtë si të palejueshme, për shkak se “nuk kanë konsumuar të gjitha mjetet juridike që kanë në disponim në vendin e tyre”.

BIBLIOGRAFIA

Ligje:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare nr. 52/91, amendamentet e publikuara në Gazetën Zyrtare nr. 1/92, 31/98, 91/01, 84/03 dhe 107/05)
- Ligjin mbi gjykatat, (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 58/2006 dhe 35/2008)
- Ligji mbi procedurën kontestimore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 79/2005)
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 dhe e azhurnuar me: 9675/07 dhe 9904/08
- Ustaven zakon na Ustaven sud na Republika Hrvatska (Narodne novine br.31/91; br.49/02)
- Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland vom 23. Mai 1949 (BGBl. S. 1), zuletzt geändert durch Artikel 1 des Gesetzes vom 19. März 2009 (BGBl. I S. 606)
- Legge Pinto, nr .89/2001
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut e miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1950

Literaturë juridike:

- Eljash Marko, Pravo na suđenje u razumnom roku, Zagreb, 2006
- Georgievski Stefan, Nova načela građanskog pravosuđenja, Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol.56 No.2-3.2006
- Karakamisheva Tanja „Analiza za potrebata na voveduvanje ustavna zhalba (tuzhba) vo Republika Makedonija“ Praven Resursen Centar, Skopje, 2007, fq.7,
- Mark W. Janis- Richard S. Kay-Anthony W. Bradley, E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Prishtinë 2002, fq. 522
- Milutinović Ljubica, Suđenje u okviru Razumnog Vremenskog roka, Pravni Informator, br.11/2004, Beograd
- Radolović Aldo, Zashtita prava na suđenje u razumnom roku, Zbornik pravnog fakulteta Sveučiliste u Rijeci, br.1 (2008), fq.6
- Tanasković Zoran, Ljudska prava i osnovne slobode koje shtiti Evropska Konvencija, Pravni informator, br 1/ 2004
- Triva Sinisha- Dika Mihailo, Građansko parnično procesno pravo, Zagreb, 2009, fq. 207
- Hans D. Jarass-Bodo Pieroth: *Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland. Kommentar.* Beck. 10. Auflage 2009

Burime të tjera:

- Strateshki plan na ministerstvoto za pravda, 2008-2010, januari 2008

- Raport vjetor për gjendjen e lëndëve kundër Republikës së Maqedonisë për vitin 2008, Shkup, prill 2009)
- Gazeta e përditshme “Fakti”, 29.12.2008
- ABA/CELLI (American Bar Association/Central European and Eurasian Law Initiative-raport për pjesëmarrjen e pakicave në profesionin juridik në Maqedoni, Shkup, shtator, 2004)
- Të dhëna nga interneti: *<http://www.pravda.gov.mk>*